

**ALBTELECOM sha**  
**Pasqyrat Financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**  
**Së bashku me raportin e audituesit të pavarur**



## PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR .....	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....	2
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES .....	3
PASQYRA E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE .....	4
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË.....	5
PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA.....	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE .....	7
1. INFORMACION I PËRGJITHSHEM .....	7
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE.....	8
3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL.....	14
4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE .....	22
5. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE.....	23
6. LLOGARI TË ARKËTUESHME AFATGJATA .....	23
7. INVENTARI.....	24
8. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA .....	24
9. LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA .....	24
10. MJETET MONETARE.....	26
11. KAPITALI AKSIONAR.....	27
12. HUATE .....	28
13. PROVIZIONET .....	29
14. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE.....	29
15. GRANTET DHE TË ARDHURAT E SHTYRA.....	29
16. TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME .....	30
17. SHITJET NETO .....	31
18. SHPENZIMET .....	32
19. TE ARDHURA DHE SHPENZIME TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT .....	34
20. TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE .....	34
21. TATIMI MBI FITIMIN .....	34
22. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA.....	35
23. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR.....	36
24. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA .....	39
25. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT .....	39

## RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për drejtuesit dhe Aksionerët e ALBTELECOM sh.a

### Raport mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Albtelecom Sh.a (në vijim referuar si "Shoqëria") bashkëlidhur të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2014, dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit dhe pasqyrën e flukseve rrjedhjës të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur në këte datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### Përgjegjësia e Drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e vërtetë dhe të sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe ligjin Nr. 9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", dhe për kontrollin e brendshme në masën që drejtimi i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë pasaktësi materiale, si pasojë e gabimeve apo mashtrimeve.

### Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të përfutur siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë pasaktësi materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë auditimi në lidhje me vlerat dhe pohimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të pasaktësive materiale të pasqyrave financiare, si rezultat i gabimit apo mashtrimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare të Shoqërisë me qëllim që të planifikojë procedura auditimi që përshtaten me rrethanat, por jo me qëllim për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura si dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të paraqitjes së pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur opinionin tonë të auditimit.

### Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në menyrë të drejtë, pozicionin financiar të Shoqërisë Albtelecom sh.a më datën 31 Dhjetor 2014, si edhe performancën e saj financiare dhe rrjedhjen e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

15 Maj, 2015

  
Irena Hoxhë (Pulo)  
Partner Angazhimi

  
Zhuljeta Vehbiu  
Partner Angazhimi



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR  
 Me 31 Dhjetor 2014

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktivitet afatgjata materiale	4	24,459,097	25,691,124
Aktivitet afatgjata jomateriale	5	698,853	724,542
Llogari te tjera te arketueshme	6	43,308	45,871
<b>Total Aktiveve Afatgjata</b>		<b>25,201,258</b>	<b>26,461,537</b>
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>			
Inventarë	7	510,492	567,867
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	8	849,410	516,198
Llogari te arketueshme te tjera	9	405,241	499,475
Llogari te arketueshme tregtare	9	2,502,378	3,085,760
Mjetet monetare ne arke e ne banke	10	169,792	523,599
<b>Total aktive afatshkurtra</b>		<b>4,437,313</b>	<b>5,192,899</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>29,638,571</b>	<b>31,654,436</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar	11	15,000,000	15,000,000
Rezerva te tjera		(4,783,971)	(2,287,240)
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse		(2,673,849)	(2,496,731)
<b>Total kapitali aksionar</b>		<b>7,542,180</b>	<b>10,216,029</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata	12	8,991,662	10,789,679
Provizione	13	218,786	218,786
Llogari te pagueshme tregtare Afatgjata	14	2,561,506	4,007,030
Tatimi i shtyre mbi fitimin	21	668,095	
Grante e te ardhura te shtyra	15	468,091	358,591
<b>Total Detyrime afatgjata</b>		<b>12,908,140</b>	<b>15,374,086</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra	12	4,008,027	2,448,787
Llogari te pagueshme tregtare	14	4,592,915	3,120,606
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	15	138,878	182,258
Llogari te pagueshme te tjera	16	448,431	312,670
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>9,188,251</b>	<b>6,064,321</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>22,096,391</b>	<b>21,438,407</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>29,638,571</b>	<b>31,654,436</b>

Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e ketyre pasqyrave financiare.

## PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Te ardhura	17	10,598,672	11,787,206
Kosto e shërbimeve të shitura	18	(7,350,713)	(6,110,749)
<b>Fitimi (Humbja) bruto</b>		<b>3,247,959</b>	<b>5,676,457</b>
Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes	18	(2,105,333)	(2,082,826)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	18	(2,443,028)	(3,288,406)
Te ardhura /shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	19	271,370	(1,867,402)
<b>Fitimi (Humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>(1,029,032)</b>	<b>(1,562,177)</b>
<b>Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto</b>	20	<b>(976,722)</b>	<b>(909,284)</b>
<b>Te ardhura/(shpenzime) financiare neto</b>		<b>(976,722)</b>	<b>(909,284)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>(2,005,754)</b>	<b>(2,471,461)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	21	-	(25,270)
<b>Fitimi /(Humbja) e vitit</b>		<b>(2,005,754)</b>	<b>(2,496,731)</b>
<b>Totali i Fitim /(Humbjes) së vitit i takon:</b>			
Aksionerëve të Shoqërisë		(2,005,754)	(2,496,731)
Interesave të pakicës		-	-

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

**PASQYRA E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shenime	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Fitimi /(Humbja) e vitit		(2,005,754)	(2,496,731)
<b>Te ardhura te tjera gjithheperfshirese</b>			
<i>Zera qe mund te riklasifikohen me vone ne fitim/humbje:</i>			
<i>Zera qe nuk do te riklasifikohen me vone ne fitim/humbje:</i>			
Tatimi fitimi i shtyre qe regjistrohet direkt ne te ardhura te tjera gjithheperfshirese	21	(668,095)	
<b>Te ardhura te tjera gjithheperfshirese per vitin</b>		<u>(668,095)</u>	-
<b>Totali i te ardhurave gjithheperfshirese</b>		<u><u>(2,673,849)</u></u>	<u><u>(2,496,731)</u></u>
<b>Totali i te ardhurave gjithheperfshirese i takon:</b>			
Pronareve te Shoqerise		<u>(2,673,849)</u>	<u>(2,496,731)</u>
Interesave te pakices		<u>-</u>	<u>-</u>

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*

## PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi para tatimit	(2,005,754)	(2,471,461)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	2,519,828	2,110,293
Rezultati nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale	(261,915)	1,901,213
Provizione të tjera dhe zhvlerësime	297,119	621,990
Te ardhura nga interesat	(4,011)	(14,858)
Shpenzime për interesa	1,075,066	709,036
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar	57,375	(266,305)
Ndryshimi në llogari të arketueshme dhe të tjera	344,404	23,370
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	1,450,324	905,212
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>3,472,436</b>	<b>3,518,490</b>
Interesa të paguara	(974,523)	(561,147)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	-	(251,375)
<b>Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative</b>	<b>2,497,913</b>	<b>2,705,968</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(1,397,824)	(10,879,829)
Shitje të aktiveve afatgjata materiale	324,374	
Cash flow i gjeneruar nga bashkimi me Eagle Mobile		1,049,447
Mjete monetare nga bashkimi me Eagle Mobile		109,686
Interesa të marra	4,011	14,858
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>(1,069,439)</b>	<b>(9,705,838)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
(Ripagim)/ të hyra nga furnitoret afatgjate	(1,445,524)	1,590,278
(Ripagim)/ të hyra nga kerkesat për arketim afatgjate	2,563	89,587
(Ripagim)/ të hyra neto nga huatë	(339,320)	5,417,860
Dividendë paguar		
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>(1,782,281)</b>	<b>7,097,725</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>	<b>(353,807)</b>	<b>97,855</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	523,599	425,744
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>169,792</b>	<b>523,599</b>

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*



**ALBTELECOM SH.A.**

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

**PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA**

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Rezerva te tjera	Rezerva ligjore	Fitime te mbartura /humbje te akumuluar	Fitim (Humbje)	Totali
<b>01 Janar 2013</b>	15,000,000	23,153	232,302	(544,126)	2,336,611	17,047,940
Transferim ne fitime te mbartura				2,336,611	(2,336,611)	-
Fitimi i vitit					(2,496,731)	(2,496,731)
Bashkimi me Eagle Mobile				(4,335,180)		(4,335,180)
<b>31 Dhjetor 2013</b>	15,000,000	23,153	232,302	(2,542,695)	(2,496,731)	10,216,029
Transferim ne fitime te mbartura				(2,496,731)	2,496,731	-
Fitimi/humbja e vitit					(2,005,754)	(2,005,754)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse					(668,095)	(668,095)
<b>31 Dhjetor 2014</b>	15,000,000	23,153	232,302	(5,039,426)	(2,673,849)	7,542,180

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*

Pasqyrat Financiare të vitit 2014, së bashku me shënimet u aprovuan nga manaxhimi në datë \_\_\_/\_\_\_ 2015 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Burak Yurtsever



Zv/Drejtor i Përgjithshem

Myrvete FERHATI



Dr/ Drejtorisë Kontabilitetit dhe Taksave





**SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE****1. INFORMACION I PËRGJITHSHEM**

"ALBTELECOM" SH.A. është regjistruar si shoqëri aksionere me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë, numër 20820 datë 18.02.1999, të Rregjistrimit Tregtar, në përputhje me ligjin Nr 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Kapitali i shoqërisë është 15,000,000 mijë lekë.

Shoqëria ofron një gamë të gjerë shërbimesh të tilla si: shërbimi i telefonisë fikse, interkonjeksionit për operatorë të tjerë, internetit, shërbimit ADSL, ISDN, linjave me qira, kartave të parapaguara dhe shërbimeve të tjera të telekomunikacionit.

Këshilli Mbikqyrës aktual dhe organet drejtuese të Shoqërisë janë:

**Këshilli Mbikqyrës:**

<u>Emri</u>	<u>Funksioni</u>	<u>Vendodhja</u>
Ahmet Calik	Kryetar	Turqi
Bahadır Aksoy	Zv. Kryetar	Tiranë
Rami Aslan	Anëtar	Suedi
Frederik Seiti	Anëtar	Turqi
Izzet Serhat Demir	Anëtar	Turqi
Mehmet Ertugrul Gurler	Anëtar	Turqi
Mahmut Can calik	Anëtar	Turqi

**Organet Drejtuese:**

<u>Emri</u>	<u>Funksioni</u>	<u>Vendodhja</u>
Erkan Tabak	Drejtor i Përgjithshëm	Tiranë
Burak Yurtsever	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	Tiranë
Abdulvahap Yeroglu	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	Tiranë
Ervin Shpori	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	Tiranë
Indrit Daci	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	Tiranë
Murat Cakmak	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	Tiranë
Ayse Ozden	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	Tiranë
Floreta Zhulali	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	Tiranë

Selia e shoqërisë është Rruga Myslym Shyri Nr. 42 Tiranë. Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me Licensë Nr. 3898113 dhe NIPT J61824053N.

## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe interpretimet e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29 Prill 2004 "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të Aktiveve Afatgjata Materiale të cilat paraqiten me vlerën e drejtë minus amortizimin e akumuluar.

Më 1 Shkurt 2013 shoqëria Albtelecom sha është bashkuar nga ana organizative dhe ligjore duke u integruar në një person të vetëm me anë të bashkimit me përthithje me shoqërinë e zotëruar tërësisht prej saj, Eagle Mobile sha. Si rezultat i bashkimit shoqëria përthithëse Albtelecom sha mori përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëria e përthithur Eagle Mobile sha kishte ndaj palëve të treta në datën e bashkimit.

### 2.2. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.3. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bënë efektive për Shoqërinë që prej 1 Janar 2014:

**Amendimi në SNK 32, "Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare" (publikuar në dhjetor 2011 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014).** Amendimi shtoi udhëzime për aplikimin e SNK 32 i cili trajtonte mungesën e qëndrueshmërisë së identifikuar, gjatë aplikimit të kritereve të kompensimit. Ky udhëzim përfshin qartësimin e paragrafit "momentalisht ka një të drejtë të detyruar me ligj për kompensim" dhe që disa sisteme të shlyerjes bruto mund të konsiderohen si të njëvlefshme me ato të shlyerjeve neto. Standardi përcakton se një e drejtë për kompensim (a) nuk duhet të kushtëzohet nga ngjarje në të ardhmen dhe (b) duhet të jetë i detyrueshëm me ligj në të gjitha rrethanat në vijim: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast likuidimi dhe falimentimi. Standardi i amenduar nuk ka një impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**Amendimi në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – Njësitë investuese" (publikuar në 31 Tetor 2012 dhe të bëra efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014).** Ndryshimet prezantuan përkufizimin e një njesie investuese si një njesi që (i) siguron fonde nga investitorë me qëllim shpërblimin e tyre me shërbime të menaxhimit të investimeve, (ii) angazhohet tek investitorët që qëllimi i biznesit është investimi i fondeve vetëm për rritjen e vlerës së kapitalit ose të ardhurat nga investimi dhe (iii) mat dhe vlerëson investimet e saj në bazë të vlerës së drejtë. Një njesi Investuese kërkohet të përlllogarisë për filialet vlerën e drejtë me fitim apo humbje dhe të konsolidojë vetëm ato filiale që ofrojnë shërbime të lidhura me aktivitetet investuese të njësisë. SNRF 12 u ndryshua për të futur mënyra të reja paraqitjeje, duke përfshirë gjykime të rëndësishme në përcaktimin nëse një njesi investuese dhe nëse informacioni financiar ose jo për një filial të pa konsoliduar është një synim apo i është ofruar filialit. Shoqëria nuk pret që ndryshimi të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

**Amendimi në KIRFN 21, "Taksat" (publikuar në 20 Maj 2013 dhe të bëra efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014).** Interpretimi qartëson kontabilizimin e një detyrim tatimor që nuk është tatim fitimi. Ngjarja që shkakton një detyrim është ajo ngjarje e identifikuar nga legjislacioni që shoqëron detyrimin me një pagesë takse. Fakti që njesia është ekonomikisht e detyruar të vazhdojë të operojë në një periudhë të ardhshme, ose përgatit pasqyrat financiare me supozimin e vazhdimësisë, nuk krijon një detyrim. Të njëjtat parime njihjeje aplikohen në pasqyrat financiare të ndërmjetme dhe vjetore. Zbatimi i interpretimit të detyrimeve që rrjedhin nga skemat e tregtimit të emetimeve është fakultativ. Shoqëria po vlerëson aktualisht ndikimin e ndryshimeve në pasqyrat financiare.



## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.3 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (Vazhdim)

Amendimi në *SNK 36 - "Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme të aktiveve jo-financiare"* (të publikuara në maj 2013 dhe efektive periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2014).; aplikimi më herët është i lejuar nëse SNRF 13 zbatohet për të njëjtën kontabilitet dhe të periudhës krahasuese). Amendimi heq kërkesën për të paraqitur informacion mbi shumën e rikuperueshme kur një njësi gjeneruese e mjeteve monetare ka emër të mirë ose asete jo-materiale me jetë të papercaktuar, por nuk ka patur zhvlerësime. Standardi i ndryshuar nuk kishte një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Amendimi në *SNK 39 - "Rinovimi i Derivatëve dhe Vazhdimi i Kontabilitetit Mbrojtës"* (publikuar në qershor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014 ). Ky ndryshim lejon "kontabilitetin mbrojtës" të vazhdojë në situatën kur nëe derivative, që është cilësuar si një instrument mbrojtës zëvendësohet (pra, palët kanë rënë dakord për të zëvendësuar kundërpartinë origjinale me një të re) për të kryer anulimin me një kundërparti kryesore si rezultat i ligjeve apo rregullimeve, nëse janë plotësuar disa kushte specifike.

### 2.4. Standardet dhe interpretimet e publikuara por ende të pa përvetësuara

Ne datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë publikuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentat financiarë: klasifikimi dhe matja" (amenduar në Korrik 2014 dhe efektiv për periudhat më ose pas 1 Janar 2018).
- Amendime ne SNK 19 – "Skemat e përfitimeve të përcaktuara: Kontributet e punonjësve" (publikuar në Nëntor 2013 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 Korrik 2014).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2012 (publikuar në Dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2014, përveç kur shprehet ndryshe më poshtë).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2013 (publikuar në Dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Korrik 2014).
- SNRF 14, "Llogaritë e shtyra rregulatore" (publikuar në Janar 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Kontabilizimi për blerjet e interesave në Operacionet e Përbashkëta – Amendime në SNRF 11 (publikuar më 6 Maj 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Qartësimi i metodave të pranueshme për Amortizimin dhe Zhvlerësimin – Amendime në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 Maj 2014 dhe efektiv për periudhat më ose pas 1 Janar 2016).
- SNRF 15, "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët" (publikuar më 28 Maj 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2017).
- Bujqësi: Bimët Prodhuese – Amendime në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar më 30 Qershor 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 Janar 2016).
- Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale – Amendimet në SNK 27 (publikuar më 12 Gusht 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më 1 Janar 2016).
- Shitje ose Kontribut në asete midis një Investitori dhe bashkëpunorit te tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Amedime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 Shtator 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2014 (publikuar në 25 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2016).
- Dhënia e informacioneve shpjeguese sipas Amendimeve të SNK 1 (publikuar në Dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat më ose pas 1 Janar 2016).
- Njësite ekonomike investuese: Aplikimi i Përyshimit të Konsolidimit amendim në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar në Dhjetor 2014 dhe efektiv për periudhat më ose pas 1 Janar 2016).



## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.4. Standardet dhe interpretimet e publikuara por ende të pa përvetësuara (Vazhdim)

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të behën efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

### 2.5. Monedha raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë. Të gjitha informacionet financiare janë rrumbullakosur në mijëshen më te afërt, përveçse kur deklarohet ndryshe.

### 2.6. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e eksperteve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### 2.6.1. Jeta e dobishme e aktiveve

Percaktimi i jetës së dobishme të aktiveve bazohet në përvojën historike me asete të ngjashme si dhe çdo zhvillim teknologjik të parashikuar dhe ndryshimet në faktorët ekonomikë dhe industrialë. Përshtatshmëria e vlerësimeve të jetës së dobishme të aktiveve rishikohet çdo vit, ose në çdo kohë kur ka një tregues për ndryshime të rëndësishme në supozimet themelore.

Shoqëria beson se ky është një vlerësim kontabël kritik për shkak se përfshin supozime mbi zhvillimet teknologjike, në një degë shumë inovative si telekomunikacioni. Për më tepër për shkak të peshës së konsiderueshme të aktiveve afatgjata në totalin e aktiveve, këto supozime mund të jenë materiale në pozicionin aktual financiar të shoqërisë dhe në rezultatin e operacioneve të shoqërisë.

#### 2.6.2. Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjëndjen e inventarit me qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.6. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

#### 2.6.3. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paafesia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Keto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftesisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Keto faktore rishikohen periodikisht dhe ndryshimet pasqyrohen tek llogaritjet në rast se është e nevojshme. Vlerësimet gjithashtu përfshijnë supozime në lidhje me sjelljen e konsumatorëve në të ardhmen dhe arkëtimet e ardhshme. Nëse kushtet financiare të klientëve përkeqësohen, çrregjistrimi aktual i llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të tejkalojë pritshmëritë dhe mund të tejkalojë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri më tani. Manaxhimi vlerëson llogaritë e arkëtueshme të cilat janë të vonuara në arkëtim, të cilat nuk janë zhvlerësuar deri në masën e vlerës së rikuperueshme në arkëtimet në periudhat paraardhëse.

#### 2.6.4. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të mase me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Në mënyrë që të përcaktohet probabiliteti i një rezultati të ardhshëm, shoqëria përdor këshillues ligjor të brendshëm dhe të jashtëm.

## 2.7. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Shifrat krahasuese janë riklasifikuar konform ndryshimeve në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet përfshijnë riklasifikime brenda zërave të seksionit të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrën e pozicionit financiar si edhe në pasqyrën e fitim humbjes.

Gjithashtu është riparaqitur huaja neto nga komisionet e disbursimeve për 51,195 mijë lek, e cila në vitin 2013 ishte paraqitur në zërin "Shpenzime të periudhave të ardhme".

Sa më sipër paraqiten të detajuara në tabelat e mëposhtme.

Me përjashtim të pasqyrës së pozicionit financiar dhe shënimeve të lidhura me të, informacioni kontabël i paraqitur në pasqyrat financiare të shoqërisë dhe në shënime të tjera shpjeguese bashkëngjitur, nuk është i krahasueshëm, pasi përthithja e shoqërisë Eagle Mobile është realizuar më 1 Shkurt 2013.



## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

## 2.7. Krahasueshmëria e informacionit kontabël (vazhdim)

AKTIVE	31.12.2013	riparaqitje per efekt krahasueshmerie	31.12.2013
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Aktivet afatgjata materiale	25,691,124	-	25,691,124
Aktivet afatgjata jomateriale	724,542	-	724,542
Llogari te tjera te arketueshme	45,871	-	45,871
<b>Total Aktiveve Afatgjata</b>	<b>26,461,537</b>	<b>-</b>	<b>26,461,537</b>
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Inventarë	567,867	-	567,867
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	164,546	351,652	516,198
Llogari te arketueshme te tjera	902,322	(402,847)	499,475
Llogari te arketueshme tregtare	3,085,760		3,085,760
Mjetet monetare ne arke e ne banke	523,599		523,599
<b>Total aktive afatshkurtra</b>	<b>5,244,094</b>	<b>(51,195)</b>	<b>5,192,899</b>
<b>Total Aktive</b>	<b>31,705,631</b>	<b>(51,195)</b>	<b>31,654,436</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar	15,000,000	-	15,000,000
Rezerva te tjera	(2,287,240)	-	(2,287,240)
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse	(2,496,731)	-	(2,496,731)
<b>Total kapitali aksionar</b>	<b>10,216,029</b>	<b>-</b>	<b>10,216,029</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata	10,827,584	(37,905)	10,789,679
Provizione		218,786	218,786
Llogari te pagueshme tregtare Afatgjata	4,007,030	-	4,007,030
Grante e te ardhura te shtyra	540,849	(182,258)	358,591
Detyrime te tjera afatgjata		-	
<b>Total Detyrime afatgjata</b>	<b>15,375,463</b>	<b>(1,377)</b>	<b>15,374,086</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra	2,462,077	(13,290)	2,448,787
Llogari te pagueshme tregtare	3,120,606	-	3,120,606
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime		182,258	182,258
Llogari te pagueshme te tjera	531,456	(218,786)	312,670
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>	<b>6,114,139</b>	<b>(49,818)</b>	<b>6,064,321</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>21,489,602</b>	<b>(51,195)</b>	<b>21,438,407</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>	<b>31,705,631</b>	<b>(51,195)</b>	<b>31,654,436</b>



## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

## 2.7. Krahasueshmëria e informacionit kontabël (vazhdim)

	31.12.2013	riklasifikime per efekt krahasueshmerie	Riklasifikuar 31.12.2013
Te ardhura	11,787,206	-	11,787,206
Kosto e sherbimeve te shitura	(8,080,036)	1,969,287	(6,110,749)
Fitimi (Humbja ) bruto	3,707,170	1,969,287	5,676,457
Shpenzimet e shitjes dhe shperndarjes	-	(2,082,826)	(2,082,826)
Shpenzime te pergjitheshme dhe administrative	(3,401,946)	113,540	(3,288,406)
Humbje nga dalja jashte perdorimit e AAM- ve	(1,901,213)	1,901,213	-
Te ardhura /shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		(1,867,402)	(1,867,402)
Fitimi (Humbja ) nga veprimtarite e shfrytezimit	(1,595,989)	33,812	(1,562,177)
Te ardhura te tjera	33,812	(33,812)	
Te ardhura/(Shpenzime) financiare neto	(909,284)	-	(909,284)
Te ardhura/Shpenzime) financiare neto	(875,472)	(33,812)	(909,284)
Fitimi para tatimit	(2,471,461)	-	(2,471,461)
Shpenzime tatim fitimi i shtyre			
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	(25,270)	-	(25,270)
Fitimi /(Humbja) e vitit	(2,496,731)	-	(2,496,731)

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Me përjashtim të ndonjë efekti që mund të rrjedhë nga ndryshimet në politikat kontabël të përshkruar në shënimin 2.4 të këtyre pasqyrave financiare, shoqëria ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël të paraqitura në vijim:

#### 3.1. Instrumentat Financiarë

Shoqëria ka vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë, të përbërë nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Shoqëria nuk ka instrumenta financiarë të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes apo të disponueshme për shitje në datën e raportimit.

##### 3.1.1. Njohja fillestare dhe çregjistrimi

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivitet financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Detyrimet financiarë çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

##### 3.1.2. Njohja e mëtejshme

###### *Paraja dhe ekuivalentët e parasë*

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre maten më tej me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimet.

###### *Huatë dhe Llogari të arkëtueshme*

Huatë e dhëna dhe Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontojnë.

###### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

###### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.



### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.1. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Kostot e huadhënies kapitalizohen si pjese e kostos së një aktivi që kërkon domosdoshmerisht një periudhe të rëndësishme për t'u përgatitur për përdorimin e destinuar apo shitjen e tij. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe detyrimet financiare të mësipërme zhvlerësohen sikurse dhe nëpërmjet procesit të amortizimit.

Interesat e përllogaritura janë njohur në pasqyrën e të ardhura-shpenzimeve dhe si detyrim në llogarinë interesa të përllogaritura.

#### *Zhvlerësime të aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Veshtiresitë e konsiderueshme financiare të debitorit, propabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa janë disa shembuj treguesish për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Aktivet e rëndësishme financiare testohen në mënyrë individuale për zhvlerësim. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, mbi baze grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut financiar.

Humbja nga zhvlerësimi lidhur me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit të aktivit.

Vlera kontabël neto e një aktivi zvogelohet nëpërmjet llogarisë për zhvlerësime dhe vlera e humbjes nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi vazhdojnë të rriten mbi vlerën kontabël të aktualizuar, bazuar në normën fillestare të interesit efektiv. Llogaritë e arkëtueshme së bashku me fondin rezervë të zhvlerësimit që i shoqëron, çregjistrohen atëherë kur nuk ka shpresa për rikuperim real në të ardhmen.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Nëse në një vit pasues, shumat e humbjeve të vlerësuar nga zhvlerësimi rriten apo ulet për shkak të një ngjarje pas njohjes fillestare të aktivit, humbja nga zhvlerësimi i njohur më parë rritet apo reduktohet duke rregulluar llogarinë e fondit rezervë të zhvlerësimeve. Nëse një aktiv i çregjistruar më parë, rikuperohet, ky rikuperim njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### 3.1.3 Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivitet dhe pasivet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe të shlyhet detyrimi njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe nderkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

#### 3.1.4 Përcaktimi i Vlerës së Drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.



### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.2 Inventari

Inventarët që përfshijnë kartat SIM, kartat me parapagesë, aparatet dhe aksesoret përkatës dhe kancelari e paisje të tjera të konsumueshme, paraqiten me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus koston e përllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

#### 3.3 Aktivet Afatgjata Materiale

Zërat e llogarisë toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje të telekomunikacionit janë të paraqitura me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale paraqiten me koston duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kosto historike përfshin çmimin e blerjes, përfshirë detyrimet e importit, dhe taksa të pakthyeshme në blerje, pasi pakësohet nga zbritjet tregëtare, çdo kosto tjetër për të sjellë aktivin në vendodhjen dhe kushtet e nevojshme në mënyrë që të jetë i gatshëm për përdorim në mënyrën e parashikuar nga manaxhimi i shoqërisë, si dhe koston për çmontimin e asetit në rast se është e nevojshme.

Çdo interes i lidhur me një aktiv afatgjatë material në ndërtim, kapitalizohet në momentin kur fillon ndërtimi i aktivit dhe pushon se kapitalizuar në momentin kur aktivin përfundon së ndërtuari.

Kosto historike e pasisjeve të telekomunikacionit përfshin të gjitha shpenzimet përfshirë dhe shtrirjen e rrjetit në ambjentet e konsumatoreve. Kosto përfshin punën e gjeneruar së brendshmi për një zë specifik të aktiveve afatgjata materiale.

Kosot e mëpasshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të asetit, ose njihen si aset më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin në fjalë, do të rrjedhin në shoqëri dhe koston e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbartur e një pjese që zëvendësohet rregjistrohet. Të gjitha koston e mirëmbajtjeve dhe riparimeve i ngarkohen periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Ndërtimi në proces përfshin punën e kontraktuar nga palët e treta ose punën e gjeneruar për qëllime të brendshme për aktivet afatgjata materiale ende të papërfunduara. Ky zë paraqet investimet e kryera (por ende të papërfunduara) në periudhën aktuale dhe/ose paraardhëse financiare. Pas përfundimit, këto aktive dhe shumat e lidhura me to të mbartura nën zërat e parapagimeve në avancë, ose ndërtimeve në proces, kapitalizohen si zëra të aktiveve afatgjata materiale.

Për të përcaktuar nëse një aktiv që ka në përbërjen e tij si elemente materiale ashtu dhe jomateriale, duhet të trajtohet sipas SNK 16 - Aktivet Afatgjata Materiale apo sipas SNK 38 - Aktive afatgjata jomateriale, manaxhimi përdor gjykimin për të përcaktuar se cili element është më i rëndësishëm, në mënyrë që të rregjistrojë aktivin siç duhet.

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****3.3. Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)**

Amortizimi vjetor paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Normat vjetore të amortizimit aplikohen mbi vlerën e mbetur të aktiveve dhe janë si vijon:

Aktivet afatgjata materiale	Norma e amortizimit %	
	2014	2013
Ndërtesa	5	5
Instalime Teknike (Linja)	5	5
Makineri e paisje	20	20
Mjete transporti	20	20
Mobilje orendi	20	20
Pajisje elektronike	25	25

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

*Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.4 Aktivet afatgjata Jomateriale**

Aktivët afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat dhe te drejtat për përdorim.

*Njohja dhe Matja*

Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shihni më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

*Shpenzimet e mëpasshme*

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Te gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

*Amortizimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse duke përdorur metoden lineare mbi jetëgjatesinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim. Jetëgjatesia e parashikuar e aktiveve për periudhat aktuale dhe krahasuese është 7 vjet.

**3.5 Zhvlerësimi (Rënia në vlerë)**

Shoqëria vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se evidentohen tregues të tillë, atëhere vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Për aktivet jomateriale që nuk janë të gatshme për përdorim, vlera e rikuperueshme përlogaritet në çdo datë të bilancit.



### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.5. Zhvlerësimi (rënia në vlerë)

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëhere kur vlera e mbartur e aktivitet apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivitet apo një njësie që gjeneron flukse para është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Për të vlerësuar vlerën në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normën para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivitet.

Humbja nga zhvlerësimi anulohet nëse ka tegues që kjo humbje nuk ekziston më dhe nëse kanë ndryshuar supozimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet deri në masën që vlera e mbartur e aktivitet nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar pasi të ishte zbritur zhvlerësimi dhe amortizimi, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

#### 3.6 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitet dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### 3.7 Grantet

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur në një mënyrë sistematike dhe proporcionale përgjate jetës së dobishme të aktivitet.

#### 3.8 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar (nëse është materiale) flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin që janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivitet e kushtezuara nuk njihen por paraqiten në shënime kur janë të rëndësishme.



**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****3.9 Konvertimi i monedhave të huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit emërtuara në monedhë të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në LEK):

<u>Monedha</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
1 EUR	140.14	140.20
1 USD	115.23	101.86
1 SDR	166.90	156.86

**3.10 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet ekonomike të rrjedhin në shoqëri dhe shumat e tyre mund të maten në mënyrë të besueshme. Të ardhurat në pasqyrat financiare paraqiten neto nga zbritjet apo kthimet.

*Shërbimet*

Të ardhurat nga shërbimet regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me perfundimin e shërbimit në datën e raportimit dhe vetëm kur ato mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Të ardhurat nga shërbimet konsistojnë në:

- tarifat e abonimit,
- tarifat e shërbimit telefonik,
- pajtimi mujor dhe shërbime të tjera
- tarifat roaming
- shërbimet e interkonjeksionit.

Të ardhurat nga këto shërbime njihen si më poshtë:

*Tarifat e abonimit*

Të ardhurat e lidhura me tarifat mujore për shërbimet e rrjetit njihen në të njëjtin muaj kur shërbimi i telekomunikacionit ofrohet.

*Shërbimi telefoqiraniq, pajtimi mujor dhe tarifa të tjera*

Shërbimi telefonik bazohet në trafikun e krijuar nga koha e bisedes e kryer nga abonenti, tarifa e aplikuar, destinacioni i thirrjes dhe lloji i shërbimit. Tarifat e shërbimit telefonik varen nga trafiku, koha e bisedës së përdorur apo volumi i të dhënave të transmetuara për shërbimet me vlerë të shtuar, përdorimi i internetit dhe shërbimet e të dhënave. Të ardhurat nga shërbimi telefonik dhe shërbimet me vlerë të shtuar njihen në periudhën kur shërbimet ofrohen. Të ardhurat e pafaturuara nga cikli i faturimit që daton në fund të çdo muaji, përllogariten në bazë të trafikut dhe regjistrohen në fund të muajit.

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.10. Njohja e të ardhurave (vazhdim)

##### *Shitja e Kartave të parapaguara*

Të ardhurat nga shitja e kartave rimbushëse me parapagesë dhe kohës së bisedës për shërbimin me parapagesë, neto nga uljet e lejuara, të përfshira në paketat e shërbimit me parapagesë të Shoqërisë, njihen në bazë të përdorimit. Koha e papërdorur e paketave me parapagim regjistrohet si e ardhur e shtyre në pasqyrën e pozicionit financiar.

##### *Tarifat Roaming*

Tarifat roaming faturohen për çdo minutë kundrejt operatorëve të tjerë për abonentët e tyre që përdorin rrjetin e shoqërisë. Në të njëjtën mënyrë edhe operatorët faturojnë Shoqërinë për përdorimin e rrjeteve të tyre nga abonentët e kësaj të fundit. Keto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në periudhën kur shërbimet janë ofruar.

##### *Tarifat e Interkonjeksionit*

Të gjitha thirrjet që kanë një numër Albtelecom si numër terminimi dhe abonentin e një shoqërie tjetër si numër origjinues, krijojnë një marrëdhënie të ardhurash midis ALBTELECOM-it dhe shoqërisë tjetër. Këto të ardhura njihen si të ardhura interkonjeksioni mes dy shoqërive.

Të ardhurat e Interkonjeksionit burojnë nga të gjitha thirrjet që terminojnë në rrjetin e ALBTELECOM-it nga rrjete të operatorëve të huaj, vendas, fiks dhe celular.

Të gjitha thirrjet që kanë një numër ALBTELECOM si numër origjinues dhe abonentin e një shoqërie tjetër si numër terminues, krijojnë një marrëdhënie kostoje midis shoqërisë tjetër dhe ALBTELECOM-it. Kjo kosto njihet si kosto interkonjeksioni mes dy shoqërive. Kostot e Interkonjeksionit burojnë nga të gjitha thirrjet e origjinuara në rrjetin e ALBTELECOM-it dhe të terminuara në rrjete të operatorëve të huaj, vendas, fiks dhe celular, duke përdorur rrjetet e shoqërive.

Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në pasqyrën e të ardhurave në kohën kur thirrja merret/pranohet në rrjetin e Shoqërisë (dhe në rrjetin e operatorit tjetër përkatesisht)

##### *Mallrat*

Të ardhurat nga shitja e aksesorëve, neto nga uljet e lejuara, njihen në momentin e dorëzimit të mallrave kur e drejta e pronësisë dhe rreziku i humbjes i kalojnë klientit.

##### *Linjat e dhëna me qira*

Shoqëria jep me qira linja kryesisht operatorëve mobile në mënyrë që rrjeti i tyre të lidhet me rrjetin fiks të Albtelekom Sh.a.. Të ardhurat fikse të qirase për këto linja njihen në bazë të metodës lineare mbi kushtet kontraktuale të qerasë. Të ardhurat nga qiratë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës lineare sipas kohezgjatjes së qirasë.

##### *Të Ardhurat dhe shpenzimet Financiare*

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur akumulohen, duke marrë parasysh metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet për interesa përfshijnë interesin e pagueshëm mbi borxhet e marra për qëllime të kapitalit të punës, të përlllogaritur me metodën e normës efektive të interesit.



### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.11 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbehet nga tatimi aktual edhe tatim fitimi i shtyre. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2014 është 15% (2013: 10%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili perlllogaritet për te evidentuar diferencat e perkoheshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabel të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normen tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktive dhe detyrime për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e perkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e perkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

#### 3.12 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shendetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### 3.13 Aktivët dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

#### 3.14 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.



ALBTELECOM SH.A.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

<i>Kosto</i>	Toka		Linja dhe paisje te telekomunikacionit	Makineri e paisje	Mjete Transporti	Paisje zyre e informatike	Aktive ne proces	Totali
	Ndertesa	Ndertesa						
Gjendja me 1 Janar 2013	5,364,666	12,159,100	4,931,389	269,407	583,875	2,282,547	25,590,984	
Shtesa	195,016	773,440	2,168,957	74,634	146,041	314,927	3,673,015	
Shtesa nga kombinimi i bizneseve	3,518,874		4,648,327	25,119	821,321	411,060	9,424,701	
Nxjerrje jashtë përdorimit		(1,179,793)	(2,939,953)	(6,893)	(794)		(4,127,433)	
Transferime	24,198	1,252,094	874,532		161,196	(2,312,020)	-	
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>9,102,754</b>	<b>13,004,841</b>	<b>9,683,252</b>	<b>362,267</b>	<b>1,711,639</b>	<b>696,514</b>	<b>34,561,267</b>	
Shtesa	9,213	(1,024)	11,839	9,339	28,709	1,223,564	1,281,640	
Nxjerrje jashtë përdorimit	(26,582)	(128)	(13,783)	(142,804)	(14,926)	(43)	(198,266)	
Transferime	29,185	169,991	585,990	-	727,449	(1,512,615)	-	
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>9,114,570</b>	<b>13,173,680</b>	<b>10,267,298</b>	<b>228,802</b>	<b>2,452,871</b>	<b>407,420</b>	<b>35,644,641</b>	
<i>Amortizimi i akumuluar</i>								
Gjendja me 1 Janar 2013	976,583	1,873,833	2,620,419	189,136	396,759		6,056,730	
Shtesa nga kombinimi i bizneseve	440,382		1,996,215	13,668	456,772		2,907,037	
Amortizimi i vitit	350,194	490,423	983,206	25,151	142,720		1,991,694	
Nxjerrje jashtë përdorimit		(222,206)	(1,915,142)	(3,172)	(726)		(2,141,246)	
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1,767,159</b>	<b>2,142,050</b>	<b>3,684,698</b>	<b>224,783</b>	<b>995,525</b>	<b>-</b>	<b>8,814,215</b>	
Amortizimi i vitit	367,560	546,770	1,221,245	26,510	289,123		2,451,208	
Nxjerrje jashtë përdorimit	(6,739)	(19)	(10,054)	(107,621)	(11,374)		(135,807)	
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>2,127,980</b>	<b>2,688,801</b>	<b>4,895,889</b>	<b>143,672</b>	<b>1,273,274</b>	<b>-</b>	<b>11,129,616</b>	
<i>Zhvierësimi i AAM-ve</i>								
Gjendja më 31 Dhjetor 2013			504	361	9,526	45,537	55,928	
Gjendja më 31 Dhjetor 2014			504	361	9,526	45,537	55,928	
<i>Vlera neto kontabël</i>								
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	7,335,595	10,862,791	5,998,050	137,123	706,588	650,977	25,691,124	
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	6,986,590	10,484,879	5,370,905	84,769	1,170,071	361,883	24,459,097	

#### 4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)

Shoqëria vlerëson aktivet e saj me vlerën e drejtë siç pershkruhet në shënimin 3.5 të këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria ka kryer rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2008. Deri më 31 Dhjetor 2014 nuk është kryer ndonjë rivlerësim tjetër i aktiveve afatgjata materiale. Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkojnë kryerjen e rivlerësimit të zërave të aktiveve afatgjata materiale periodikisht çdo 3 ose 5 vjet në rast se ekzistojnë tregues që vlera e drejtë e këtyre aktiveve ka ndryshime të rëndësishme nga vlera e mbartur e tyre. Manaxhimi gjykon se nuk ekziston ndonjë tregues që vlera e drejtë e aktiveve afatgjata materiale ka ndryshime të rëndësishme, për shkak të futjes së teknologjisë së re dhe zëvendësimit të një pjese të aktiveve afatgjata materiale, si dhe të kompatibilitetit të teknologjisë së futur rishtazi me atë ekzistuese.

#### 5. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Lëvizjet e aktiveve afatgjata jomateriale për vitin 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	AAJM	Total
<b>Me kosto</b>		
Gjendja më 1 Janar 2013	150,120	150,120
Shtesa	48,444	48,444
Shtesa nga kombinimi I biznesit	795,539	795,539
Pakesime	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	994,103	994,103
Shtesa	116,184	116,184
Pakesime	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	1,110,287	1,110,287
<b>Amortizimi</b>		
Gjendja më 1 Janar 2013	81,101	81,101
Amortizimi i vitit	120,973	120,973
Shtesa nga kombinimi I biznesit	67,487	67,487
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	269,561	269,561
Amortizimi i vitit	141,873	141,873
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	411,434	411,434
	-	-
<b>Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>724,542</b>	<b>724,542</b>
<b>Gjendja Neto me 31 Dhjetor 2014</b>	<b>698,853</b>	<b>698,853</b>

#### 6. LLOGARI TË ARKËTUESHME AFATGJATA

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kredi te dhena personelit	43,308	45,871
<b>Total</b>	<b>43,308</b>	<b>45,871</b>

Në zërin "Kredi të dhëna" pasqyrohet kredia e dhënë punonjësve për banesa e cila vazhdon të shlyhet mbi bazën e kontratave 20 -25 vjeçare duke filluar nga vitit 1997.

**7. INVENTARI**

Gjëndjet e inventarit janë te analizuara si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Materiale te para	309,305	455,030
Produkte e mallra	377,574	282,014
Te tjera gjendje inventari	15,553	22,763
Zhvleresimi per inventare	(191,940)	(191,940)
<b>Total</b>	<b><u>510,492</u></b>	<b><u>567,867</u></b>

**8. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA**

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Parapagime per furnitoret	555,298	200,835
Parapagimet per tatimin mbi fitimin	229,179	229,179
Shpenzime te shtyra	64,933	86,184
<b>Total</b>	<b><u>849,410</u></b>	<b><u>516,198</u></b>

**9. LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA****9.1. Analiza e llogarive të arkëtueshme**

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kliente per shitje e sherbime	6,260,432	6,546,695
Zhvleresimi i Kerkesave per arketim	(3,758,054)	(3,460,935)
<b>Neto llogari te arketueshme tregtare</b>	<b><u>2,502,378</u></b>	<b><u>3,085,760</u></b>
Te tjera kerkesa te arketueshme	753,160	847,394
Zhvleresimi I te tjerave te arketueshme	(347,919)	(347,919)
<b>Neto llogari te tjera te arketueshme</b>	<b><u>405,241</u></b>	<b><u>499,475</u></b>
<b>Total</b>	<b><u>2,907,619</u></b>	<b><u>3,585,235</u></b>



## 9. LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA (VAZHDIM)

## 9.2. Llogaritë e arkëtueshme ndaj klientëve

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kliente per trafikun kombetar		
Abonente Familjare	2,322,488	2,303,780
Abonentet biznes	1,521,453	1,551,758
Minus Zhvleresimi	(3,158,091)	(2,860,972)
Kliente per trafikun nderkombetar	1,415,393	1,584,594
Minus Zhvleresimi	(599,963)	(599,963)
Operatore Internet & qira linjash	246,172	220,294
Distributoret e Kartave	218,615	245,346
Kliente te tjere	536,311	640,923
<b>Total</b>	<b><u>2,502,378</u></b>	<b><u>3,085,760</u></b>

## 9.3. Kërkesat për arkëtim ndaj klientëve të trafikut ndërkombëtar sipas vjetërsisë janë të klasifikuara si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kerkesa per arketim deri ne 1 vit	520,543	738,730
Kerkesa per arketim mbi 1 vit	894,850	845,864
<b>Total</b>	<b><u>1,415,393</u></b>	<b><u>1,584,594</u></b>

## 9.4. Të tjera Llogari të Arkëtueshme Afatshkurtra

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
TVSH per tu rimbursuar	621	213,412
Parapagim Detyrimi sipas akt kont gjoba&interesa	510,447	476,529
Te tjera kerkesa	242,092	157,453
Minus Zhvleresimi kerkesa te tjera	(347,919)	(347,919)
<b>Total</b>	<b><u>405,241</u></b>	<b><u>499,475</u></b>

**9. LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA (VAZHDIM)****9.5. Provizionet për zhvlerësim për kërkesat për arkëtim**

Gjatë vitit 2014 në llogaritë e provizioneve për zhvlerësimin e kërkesave për arkëtim, kanë ndodhur lëvizjet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Gjendja me 1 Janar	3,808,854	2,719,749
Shtesa zhvlerësime	297,119	581,887
Shtesa zhvlerësime nga bashkimi me Eagle Mobile	-	507,218
Rimarrje per vitin	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor	<u>4,105,973</u>	<u>3,808,854</u>

**10. MJETET MONETARE**

Mjetet monetare më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Mjete monetare në arkë	56	599
Llogari rrjedhese	106,584	213,935
Para në depozitë me afat	-	280,400
Para të bllokuara në llogari	22,737	17,533
Para në udhetim	40,415	10,313
Kartat e Parapaguara	-	23
Interesat e Maturuara	-	796
	<u>169,792</u>	<u>523,599</u>

Më poshtë mjetet monetare detajohen sipas monedhave:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Mjete monetare në bankë	129,321	511,868
në USD	2,880	10,981
në EURO	41,820	357,195
në ALL	84,480	141,669
në GBP	124	226
në TRY	17	1,797
Interesa të maturuara	-	796
Mjete monetare në arkë	56	599
në EURO	-	27
në ALL	56	572
Kartat e parapaguara për shitje	-	23
Para në udhetim	40,415	10,313
	<u>169,792</u>	<u>523,599</u>

## 11. KAPITALI AKSIONAR

Struktura dhe shuma e kapitalit është si më poshtë :

	31 Dhjetor 2014			31 Dhjetor 2013		
	%	Nr Aksioneve	Kapitali i nënshkruar	%	Nr Aksioneve	Kapitali i nënshkruar
METE	16.77%	2,515,255	2,515,255	16.77%	2,515,255	2,515,255
Posta Shqiptare	3.00%	450,000	450,000	3.00%	450,000	450,000
Aksionere te tjere (persona fizik)	4.23%	634,745	634,745	4.23%	634,745	634,745
CETEL	76.00%	11,400,000	11,400,000	76.00%	11,400,000	11,400,000
<b>Totali</b>	<b>100.00%</b>	<b>15,000,000</b>	<b>15,000,000</b>	<b>100.00%</b>	<b>15,000,000</b>	<b>15,000,000</b>





**13. PROVIZIONET**

Lëvizjet e provizioneve për rreziqe paraqiten si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Gjendja me 1 Janar	218,786	218,786
Shtesa provizione	-	-
Rimarrje per vitin	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor	<u>218,786</u>	<u>218,786</u>

**14. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE**

Llogaritë e pagueshme tregtare ndahen në afatshkurtra dhe afatgjata si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Llogari te pagueshme tregtare afatgjata	2,561,506	4,007,030
Llogari te pagueshme tregtare afatshkurtra	4,592,915	3,120,606
	<u>7,154,421</u>	<u>7,127,636</u>

Llogaritë e pagueshme detajohen më tej:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
ZTE Corporation	2,900,841	3,289,154
ZTE Albania	246,050	240,460
Verso	1,478,148	1,482,178
Huawei Technologies Albania	378,884	370,352
Huawei International Pte.Ltd.	371,052	-
Verso shpk	192,020	156,128
Furnitore te tjere	1,587,426	1,589,364
	<u>7,154,421</u>	<u>7,127,636</u>

**15. GRANTET DHE TË ARDHURAT E SHTYRA**

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Grante	285,338	358,591
Te ardhura te shtyra per kohe te pakonsumuar	138,878	182,258
Te ardhura te shtyra nga AMC	182,753	-
	<u>606,969</u>	<u>540,849</u>

Grantet përfaqësojnë pajisje telekomunikacioni ndërsa të ardhurat e shtyra per kohe te pakonsumuar përfaqësojnë kohë bisede të pakonsumuar të kartave rimbushëse të shitura në fund të vitit.



## 16. TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME

Detyrimet të tjera afatshkurtra të shoqërisë janë të analizuar si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Personeli	424	15
Sigurime shoqerore	23,003	27,316
Shteti tatime e taksa	41,798	22,348
Te tjera detyrime	383,206	262,535
Ortaku	-	456
	<u>448,431</u>	<u>312,670</u>

*Detyrimet ndaj punonjësve*

Marrëdhëniet kontraktuale të shoqërisë me punonjësit e tyre bazohen në kodin e punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata kolektive e punës është lidhur ndërmjet shoqërisë dhe punonjësve të saj për përcaktimin e detyrimeve reciproke që lindin nga marrëdhënia e punës.

Sipas legjislacionit të punës në fuqi, shoqëria mund të penalizohet deri në 15 paga mujore në rast të një ndërpreje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës me punonjës të saj.

Shoqëria nuk ka krijuar ndonjë provizion lidhur me kostot e mundshme nga ndërpreja e menjëhershme dhe e pa justifikuar e kontratave të punës me punonjësit e saj.

Numri mesatar i personelit sipas funksioneve është si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Drejtores, Manaxhere e drejtues departement	155	163
Specialiste	777	783
Personel teknik	29	316
Punetore	30	88
Stafi ndihmes	12	24
	<u>1,003</u>	<u>1,374</u>

*Shteti tatim e taksa*

Shteti tatim e taksa analizohet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
TVSH per tu paguar	21,665	2,640
Tatim mbi te ardhurat Personale	20,133	19,708
	<u>41,798</u>	<u>22,348</u>

## 17. SHITJET NETO

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Sherbimi telefonik kombetar fix	2,991,826	2,950,038
Sherbimi telefonik kombetar mobile	965,848	834,939
Sherb. telefonik nderkombetar	2,973,012	4,548,872
Sherbimi Roaming	155,564	36,598
Sherbimi interkoneksionit ndaj operatoreve	1,447,217	1,037,981
Sherbimi nga kartat (Voucher, Etop-up, Albue, Albred)	1,180,943	1,032,649
Internet, ADSL, ISDN, LAN, internet IP	609,074	1,105,359
Sherbimet e instalimit	3,072	5,206
Linjat dhe qarqet me qira	46,474	46,613
Te ardhura te tjera	100,649	89,139
Sherbimi i Kartes se parapaguar	6,824	15,430
<b>Total te ardhura nga veprimtaria kryesore</b>	<b>10,480,503</b>	<b>11,702,824</b>
Nga modem dhe ADSL, Sim Card & tjera	110,190	80,022
Shitje aparati telefonik	7,979	4,360
<b>Total shitje Malli</b>	<b>118,169</b>	<b>84,382</b>
<b>Total shitje neto</b>	<b>10,598,672</b>	<b>11,787,206</b>

## 18. SHPENZIMET

Tabela me poshte paraqet shpenzimet e ndara sipas natyres dhe funksionit per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013.

	31 Dhjetor 2014			Totali
	Kosto e sherbimeve te shitura	Shpenzimet e shitjes dhe shperndarjes	Shpenzime te pergjitheshme dhe administrative	
Operatoret Mobile AMC	1,150,656	-	-	1,150,656
Operatoret Mobile Vodafon	372,834	-	-	372,834
Operatoret Mobile Eagle	727	-	-	727
Operatoret Mobile PLUS	88,661	-	-	88,661
Operatoret Rurale/alternativ	42,817	-	-	42,817
Operatore te tjere (vas)	-	12,903	-	12,903
Operatoret Nderkombetare	574,572	-	-	574,572
Shpenzime Interneti	-	-	111,712	111,712
Licensa	139,341	-	-	139,341
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	72,174	9,578	81,752
Shpenzimet e Mirembajtjes	861,677	66,852	239,791	1,168,320
Shpenzime Qiraje	213,078	69,900	63,194	346,172
Rojet e Objekteve	-	72,598	-	72,598
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	26,083	-	11,915	37,998
Reklame e Publicitet	-	809,507	-	809,507
Sponsorizime	-	37,298	-	37,298
Udhetime e Dieta	-	-	82,771	82,771
Uje dhe Energjie elektrike	176,917	-	86,192	263,109
Komisionet Bankare	-	-	11,233	11,233
Sherbime te ndryshme nga te 3	87,600	344,049	310,313	741,962
Shpenzime per Materiale	291,573	13,935	64,014	369,522
Shpenzime per Mallra	379,828	39,310	-	419,138
Tatime e taksa	100	-	32,776	32,876
Pagat	492,301	354,976	543,831	1,391,108
Tajtime dhe shperblime te tjera	146,537	105,661	161,875	414,073
Sigurime shoqerore	66,761	48,139	73,749	188,649
Amortizimi	2,238,650	58,031	223,147	2,519,828
Provisione	-	-	297,119	297,119
shpenzime te tjera rrjedhese	-	-	119,818	119,818
<b>Totali</b>	<b>7,350,713</b>	<b>2,105,333</b>	<b>2,443,028</b>	<b>11,899,074</b>



## 18. SHPENZIMET (VAZHDIM)

	31 Dhjetor 2013			Totali
	Kosto e shërbimeve të shitura	Shpenzimet e shitjes dhe shperndarjes	Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	
Operatorët Mobile AMC	799,089	-	-	799,089
Operatorët Mobile Vodafon	549,374	-	-	549,374
Operatorët Mobile Eagle	31,751	-	-	31,751
Operatorët Mobile PLUS	120,998	-	-	120,998
Operatorët Rurale/alternativ	149,585	-	-	149,585
Operatore të tjera (vas)	-	19,299	-	19,299
Operatorët Nderkombetare	276,328	-	-	276,328
Shpenzime Interneti	-	-	138,683	138,683
Licensa	87,707	-	-	87,707
Shpenzimet Postare dhe transporti	-	82,153	10,738	92,891
Shpenzimet e Mirembajtjes	592,921	59,009	239,393	891,323
Shpenzime Qiraje	225,127	56,148	55,352	336,627
Rojet e Objekteve	-	63,181	-	63,181
Prime Sigurime Pasurie dhe Jete	25,736	-	28,560	54,296
Reklame e Publicitet	-	739,450	-	739,450
Sponsorizime	-	31,515	-	31,515
Udhetime e Dieta	-	-	78,516	78,516
Uje dhe Energji elektrike	148,190	-	87,978	236,168
Komisionet Bankare	-	-	9,240	9,240
Shërbime të ndryshme nga te 3	17,439	326,773	458,560	802,772
Shpenzime për Materiale	247,294	19,197	85,326	351,817
Shpenzime për Mallra	171,215	80,883	-	252,098
Tatime e taksa	25,804	-	45,677	71,481
Pagat	527,882	380,632	583,136	1,491,650
Tajtime dhe shperblime të tjera	174,876	126,093	193,182	494,151
Sigurime shoqerore	73,757	53,183	81,477	208,417
Amortizimi	1,865,676	45,310	199,307	2,110,293
Provisione	-	-	581,887	581,887
shpenzime të tjera rrjedhese	-	-	411,394	411,394
<b>Totali</b>	<b>6,110,749</b>	<b>2,082,826</b>	<b>3,288,406</b>	<b>11,481,981</b>

## ALBTELECOM SH.A.

## Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Të gjitha shumat janë paraqitur në mijë Lek përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

## 19. TE ARDHURA DHE SHPENZIME TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Rezultati nga dalja jashte perdorimit dhe shitja e AAM-ve	261,915	(1,901,213)
Të ardhura të tjera rrjedhëse	9,455	33,811
<b>Totali</b>	<b><u>271,370</u></b>	<b><u>(1,867,402)</u></b>

Rezultati nga dalja jashte perdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale detajohet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga shitja e AAM	324,374	84,974
Shpenzime nga shitja e AAM	(62,459)	(1,986,187)
<b>Rezultati Neto nga shitja e AAM</b>	<b><u>261,915</u></b>	<b><u>(1,901,213)</u></b>

## 20. TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga interesat	4,011	14,858
Te ardhura nga kembimet valutore	368,375	443,118
<b>Te Ardhurat Financiare</b>	<b><u>372,386</u></b>	<b><u>457,976</u></b>
Shpenzime per interesa	(1,075,066)	(709,036)
Humbje nga kembimet valutote	(256,759)	(560,128)
Te ardhura nga rrimarje granti	(17,283)	(98,096)
<b>Shpenzimet Financiare</b>	<b><u>(1,349,108)</u></b>	<b><u>(1,367,260)</u></b>
<b>Rezultati Financiar</b>	<b><u>(976,722)</u></b>	<b><u>(909,284)</u></b>

## 21. TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin eshte perlllogaritur si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	(2,005,754)	(2,471,461)
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	1,269,392	2,724,162
Provizionet	297,119	581,887
Amortizimi tej normave te lejuara me ligj	269,048	1,375,693
Shpenzime pa dokumenta e te tjera	703,225	766,582
<i>Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</i>	<b><u>(736,362)</u></b>	<b><u>252,701</u></b>
<i>Tatim fitimi @15% (2013: 10%)</i>	-	25,270
<b>Fitimi /(Humbja) e vitit</b>	<b><u>(2,005,754)</u></b>	<b><u>(2,496,731)</u></b>

**21. TATIMI MBI FITIMIN (VAZHDIM)**

Tatimi i shtyre i perlllogaritur për vitin 2014 lidhet me sa me poshte:

	Pasqyra e pozicionit financiar	Pasqyra e te ardhurave te tjera gjitheperfshirese
Rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale	(668,095)	(668,095)
Perfitimet /(shpenzime) nga tatimet e shtyra		(668,095)
Aktivët /(pasivet) tatimore te shtyra	(668,095)	

**22. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me aksionerët e saj, me shoqëritë nën të njëjtin kontroll dhe me drejtimin dhe manaxhimin ekzekutiv të saj. Më poshtë janë detajuar palët e lidhura dhe marrëdhëniet respektive me to.

Vlerat e paraqitura ne seksionin a aktiveve me palët e lidhura me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Aktif Yatirim Bankası A.Ş.	26,765	-
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	14,604	8,710
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş	1,219	4
GAP GÜNEYDOĞU TEKSTİL SANAYİ V	1,130	
Punonjesit e Albtelecom	7,407	18,082
Posta Shqiptare		11,655
<b>Total llogari te arketueshme me palet e lidhura</b>	<b>51,125</b>	<b>38,451</b>
Aktif Yatirim Bankası A.Ş.	450	2,774
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	88,814	137,673
<b>Total mjete monetare prane paleve te lidhura</b>	<b>89,264</b>	<b>140,447</b>

Llogaritë e pagueshme me palët e lidhura detajohen si mëposhtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Aktif Yatirim Bankası A.Ş.	3,939,217	2,892,613
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	427,450	1,124
Çalık Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş	5,128	
Çalık Holding AŞ	174,858	53,633
Cetel Telekom İletişim Sanayi ve Ticaret A.Ş.		456
Posta Shqiptare	42,603	56,099
<b>Total</b>	<b>4,589,256</b>	<b>3,003,925</b>



**22. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)**

Shitjet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 detajohen si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	68,646	65,497
Çalik Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş	1,024	
GAP GÜNEYDOĞU TEKSTİL SANAYİ V	921	
Posta Shiptare		19,959
<b>Total</b>	<b><u>70,591</u></b>	<b><u>85,456</u></b>

Blerjet gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 detajohen si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Aktif Yatırım Bankası A.Ş.	271,281	67,530
Banka Kombetare Tregtare Sh.a	21,143	2,654
Çalik Enerji Sanayi ve Ticaret A.Ş	39,500	6,296
Çalik Holding AŞ	146,258	106,641
Cetel Telekom İletişim Sanayi ve Ticaret A.Ş.		74,407
Posta Shiptare		67,151
<b>Total</b>	<b><u>478,182</u></b>	<b><u>324,679</u></b>

Shperblimet e drejtoreve te perfshira ne shpenzimet e Shoqerise per vitin jane si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga, shperblime te drejtuesve	191,066	220,928
<b>Total</b>	<b><u>191,066</u></b>	<b><u>220,928</u></b>

**23. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR**

Aktivitetet e shoqërise e ekspozojnë atë ndaj një sërë risqesh financiare si: risku i kreditit, risku i likuiditetit dhe risku nga monedhat e huaja. Shoqëria nuk perdor instrumenta financiarë derivativë ose ndonjë formë tjetër mbrojtje ndaj këtyre risqeve.

Nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë formal i implementuar nga shoqëria për manaxhimin e riskut. Manaxhimi i shoqërise fokusohet më shumë në riskun e kreditit dhe riskun e likuiditetit dhe vepron rast pas rasti për të zbutur këto risqe dhe për të minimizuar humbjet.

*Objektivat dhe politikat e manaxhimit të riskut financiar*

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon të drejta për të marrë para ose asete të tjera financiare nga palët e tjera ose detyrimin për të dhënë asete të tjera financiare një palë tjetër. Instrumentat kryesore financiare të Shoqëriseë konsistojnë në para në dorë dhe në bankë, hua ndaj palëve të lidhura, llogari tregtare të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera financiare. Instrumentat financiarë krijojnë një risk për shoqërinë. Risqet më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria janë si vijon:

**23. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****23.1. Risku i Likuiditeteve**

Shoqëria gjeneron flukse të mëdha të parasë nga aktivitetet operative (psh nga mbledhja e kërkesave të arkëtueshme) në atë masë sa që beson se rreziku i likuiditeteve nuk është domethënës.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë ndertuar bazuar në maturitete kontraktuale të paskontuara të aktiveve dhe detyrimeve financiare:

Pershkrimi	31 Dhjetor 2014			Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 Vjet	
Llogari tregtare të arketueshme dhe të tjera	2,907,619		43,308	2,950,927
Mjete monetare në arke dhe banke	169,792			169,792
<b>Totali</b>	<b>3,077,411</b>	<b>-</b>	<b>43,308</b>	<b>3,120,719</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(1,894,965)	(3,146,382)	(2,561,505)	(7,602,852)
Hua	(1,735,651)	(2,286,069)	(8,977,969)	(12,999,689)
<b>Totali</b>	<b>(3,630,616)</b>	<b>(5,432,451)</b>	<b>(11,539,474)</b>	<b>(20,602,541)</b>
<b>Rrishti i likuiditetit më 31 Dhjetor 2014</b>	<b>(553,205)</b>	<b>(5,432,451)</b>	<b>(11,496,166)</b>	<b>(17,481,822)</b>

Pershkrimi	31 Dhjetor 2013			Total
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 Vjet	
Llogari tregtare të arketueshme dhe të tjera	3,585,235		45,871	3,631,106
Mjete monetare në arke dhe banke	523,599			523,599
<b>Totali</b>	<b>4,108,834</b>	<b>-</b>	<b>45,871</b>	<b>4,154,705</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(854,802)	(1,651,088)	(4,934,416)	(7,440,306)
Hua		(2,462,077)	(10,776,389)	(13,238,466)
<b>Totali</b>	<b>(854,802)</b>	<b>(4,113,165)</b>	<b>(15,710,805)</b>	<b>(20,678,772)</b>
<b>Rrishti i likuiditetit më 31 Dhjetor 2013</b>	<b>3,254,032</b>	<b>(4,113,165)</b>	<b>(15,664,934)</b>	<b>(16,524,067)</b>

**23.2. Risku i normave të interesit**

Të ardhurat si dhe rrjedhja e parave nga aktiviteti i shfrytëzimit i shoqërisë ndikohen nga përqindjet e interesit. Shoqëria ka marrë hua afatgjatë me interes të ndryshueshëm dhe me interes fikse. Shoqëria përballë me riskun e normave të interesit të fluksit të parasë lidhur me riskun e normave të interesit të çdo depozite afatshkurtër.

Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi këtij risku.

Detajimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare më 31 Dhjetor 2014 detajohet si mëposhtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>Instrumenta me interes fikse</b>		
Aktive Financiare		
Detyrime Financiare	3,239,928	4,324,000
	<b>3,239,928</b>	<b>4,324,000</b>
<b>Instrumenta me interes variable</b>		
Aktive Financiare		-
Detyrime Financiare	9,759,761	8,914,466
	<b>9,759,761</b>	<b>8,914,466</b>

## 23. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

## 23.3. Risku nga monedhat e huaja

Risku nga monedhat e huaja është risku që vlera e instrumentave financiare do të luhetet si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja. Manaxhimi nuk është futur në ndonjë derivat për t'i vënë kufi ketij risku.

Më 31 Dhjetor 2014 Balancat në monedhë të huaj detajohen si mëposhtë:

	31 Dhjetor 2014						Total
	EUR	USD	SDR	TRY	GBP	LEK	
Llogari tregtare te arketueshme dhe te tjera	643,835	928,656	234,328	-	-	1,144,108	2,950,927
Mjete monetare ne arke dhe banke	41,808	2,880	-	17	124	124,963	169,792
<b>Totali</b>	<b>685,643</b>	<b>931,536</b>	<b>234,328</b>	<b>17</b>	<b>124</b>	<b>1,269,071</b>	<b>3,120,719</b>
Llogari tregtare te pagueshme dhe te tjera	(6,573,237)	(166,850)	(43,388)	(1,007)	-	(818,370)	(7,602,852)
Hua	(13,039,278)	-	-	-	-	39,589	(12,999,689)
<b>Totali</b>	<b>(19,612,515)</b>	<b>(166,850)</b>	<b>(43,388)</b>	<b>(1,007)</b>	<b>-</b>	<b>(778,781)</b>	<b>(20,602,541)</b>
<b>Rrishti i kursit te kembimit me 31 Dhjetor 2014</b>	<b>(18,926,872)</b>	<b>764,686</b>	<b>190,940</b>	<b>(990)</b>	<b>124</b>	<b>490,290</b>	<b>(17,481,822)</b>

Më 31 Dhjetor 2013 Balancat në monedhë të huaj detajohen si mëposhtë:

	31 Dhjetor 2013					Total
	EUR	USD	SDR	TRY	LEK	
Llogari tregtare te arketueshme dhe te tjera	796,243	725,985	-	-	2,108,878	3,631,106
Mjete monetare	357,222	10,981	-	1,797	153,599	523,599
<b>Totali</b>	<b>1,153,465</b>	<b>736,966</b>	<b>-</b>	<b>1,797</b>	<b>2,262,477</b>	<b>4,154,705</b>
Llogari tregtare te pagueshme dhe te tjera	(6,642,743)	(107,495)	-	(528)	(689,540)	(7,440,306)
Hua	(13,289,661)	-	-	-	51,195	(13,238,466)
<b>Totali</b>	<b>(19,932,404)</b>	<b>(107,495)</b>	<b>-</b>	<b>(528)</b>	<b>(638,345)</b>	<b>(20,678,772)</b>
<b>Rrishti i kursit te kembimit me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>(18,778,939)</b>	<b>629,471</b>	<b>-</b>	<b>1,269</b>	<b>1,624,132</b>	<b>(16,524,067)</b>



**23. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****23.4. Risku i kreditit**

Politika e shoqërisë stimulon klientët të konsumojnë shërbimin në avancë kundrejt pagesës së mëvonshme. Ndërkohë balanca e llogarive të arkëtueshme monitorohet në vazhdimësi në mënyrë që rezultati i ekspozimit të shoqërisë ndaj borxheve të këqija të mos jetë i konsiderueshem.

Testi i vlerës së llogarive të arkëtueshme kryhet në çdo datë raportimi në baza individuale për klientet e mëdhenj. Klientet e vegjel grupohen në grupe homogjene dhe testohen në mënyrë kolektive.

Tabela më poshtë paraqet aktivet financiare për vitin mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 :

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Llogari të arkëtueshme tregtare	2,502,378	3,085,760
Llogari të tjera të arkëtueshme	448,549	545,346
Mjete monetare	169,792	523,599
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b><u>3,120,719</u></b>	<b><u>4,154,705</u></b>

Detaje mbi moshën e të arkëtueshmeve dhe zhvleresimin e tyre paraqiten në shënimin 9 të pasqyrave financiare.

**24. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA**

Angazhimet vjetore për qira operative janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Brenda një viti	193,018	301,360
Me shume se një vit, me pak se pesë vjet	984,360	33,600
	<b><u>1,177,378</u></b>	<b><u>334,960</u></b>

Shoqëria është e përfshirë në çështje gjyqësore të ndryshme gjatë rrjedhës normale të biznesit. Në gjykimin e manaxhimit rezultati final i këtyre çështjeve nuk do të ketë një impakt material në rezultatin aktual të shoqërisë.

**25. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT**

Më 31 Dhjetor 2014 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.